



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

### GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

**Numri i Ceshtjes :** 31004-02603-80-2017      **Data e Regjistrimit :** 25/04/2017  
**Numri i Vendimit:** 80-2017-2764              **Data e Vendimit :** 19/06/2017

### VENDIM

### NE EMER TE REPUBLIKES

### GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

**GJYQTAR:** {...}

**SEKRETARE:** {...}

Sot me date 19/06/2017mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites SHOQERIA {...} SHPK I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale

**Objekti:**1. Shfuqizimi i Vendimit te Bordit te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave. me numer 599/7, qe ka lene ne fuqi Vendimin nr. 599/4, 17.5.2016 qe ka vendosur Refuzimin per regjistrim te markes me numer AL/T/15/599. 2. Vendosja e regjistrimit te markes me numer AL/T/15/599.

**Baza Ligjore:**Ligji 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative; Ligji 49/2012 Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative; Neni 142 e vijues i Ligjit 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" (me poshte referuar si Ligji 9947) Kreu IV i VKM Nr. 1706, date 29.12.2008. "Per Miratimin e Rregullores per Regjistrimin e Markave Tregtare dhe te Sherbimit" (me poshte referuar si Rregullorja)

**B) Pretendimet dhe prapsimet e paleve ndergjyqese.**

Sa me lart pala paditese pretendon se:

- Me te drejte ajo kerkon te regjistroje nje marke tregtare qe jep indicie pra sugjeron ne lidhje me karakteristikat tipike te burimeve nga male te larta alpine per shkak se vet kjo shoqeri e ka stabilimentin ne nje zone te till dhe nuk mashtron publikun.
- Fjala alpe eshte konsideruar me te padrejte nga pala e paditur si nje emertim origjine.
- Alpet nuk mund te konsiderohen si nje tregues gjeografik por ato karakterizojne male me madhesi dhe madheshti te spikatur.
- Alpet nuk perbejne ndonje rajon apo lokalitet te vecant te territorit te Shqiperise. Konsumatori nuk identifikon dot asnje zone specifike duke u niser nga emertesa e markes.
- Elementet qe perbejne marken qe ne kerkojme te regjistrojme nuk kane karakter pershkrues.
- Pala e paditur ka shume praktika ku ka pranuar fjalen alpe ne regjistrimin e markave.
- Komisioni qe ka marre vendimin e bordit ka qene i formuar ne menyre te parregullt.
- Kryetari i bordit ka refuzuar me pare regjistrimin e markes tone dhe gjithashtu ka marre pjese ne komisionin e ankimit.

Sa me larte pala paditese kerkon pranimin e padise.

Pala e paditur nuk u paraqit ne gjykim nuk paraqiti as prapsime dhe as prova.

### VEREN :

## Veren:

Se pala paditese Shoqeria {...} shpk ka paraqitur per gjykim prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane kerkese - padine me, objekt dhe baze ligjore te sipercituar.

### **A) . Nga hetimi gjyqesor i geshtjes rezultuan te provuara keto fakte:**

-Pala paditese ka aplikuar prane pales se paditur per regjistrim marke, marke e cila perbehet nga elementet / fjale "Uje Natyral i Alpeve", qe pershkruajne llojin e mallit per te cilen kerkohet te regjistrohet marka.

-Me shkresen e quajtur Njoftim per Refuzimin e Regjistrimit te Markes nr 599/ 4 prot date 17/05/2016 rezulton se pala e paditur Drejtoria e Pergjitheshme e Pronesise Industriale (ish - emertesa Drejtoria e Pergjitheshme e Patentave dhe Markave) ka refuzuar regjistrimin e kesaj marke.

-Ndaj kesaj vendimarrje pala paditese ka bere ankim administrativ. Ne baze te ankimit te pales paditese Bordi i Apelimit te DPPM ka vendosur refuzimin e ankimit dhe refuzimin perfundimtar te regjistrimit te kesaj marke.

-Ndaj ketyre vendimarrjeve te pales se paditur pala paditese paraqet kete kerkese padi ne gjykate.

### **B) Pretendimet dhe prapsimet e paleve ndergjyqese.**

Sa me lart pala paditese pretendon se:

-Me te drejte ajo kerkon te regjistroje nje marke tregtare qe jep indicie pra sugjeron ne lidhje me karakteristikat tipike te burimeve nga male te larta alpine per shkak se vet kjo shoqeri e ka stabilimentin ne nje zone te till dhe nuk mashtron publikun.

-Fjala alpe eshte konsideruar me te padrejte nga pala e paditur si nje emertim origjine.

- Alpet nuk mund te konsiderohen si nje tregues gjeografik por ato karakterizojne male me madhesi dhe madheshti te spikatur.

-Alpet nuk perbejne ndonje rajon apo lokalitet te vecant te territorit te Shqiperise. Konsumatori nuk identifikon dot asnje zone specifike duke u niser nga emertesa e markes.

-Elementet qe perbejne marken qe ne kerkojme te regjistrojme nuk kane karakter pershkrues.

- Pala e paditur ka shume praktika ku ka pranuar fjalen alpe ne regjistrimin e markave.

- Komisioni qe ka marre vendimin e bordit ka qene i formuar ne menyre te parregullt.

-Kryetari i bordit ka refuzuar me pare regjistrimin e markes tone dhe gjithashtu ka marre pjese ne komisionin e ankimit.

Sa me larte pala paditese kerkon pranimin e padise.

Pala e paditur nuk u paraqit ne gjykim nuk paraqiti as prapsime dhe as prova.

### **C) Kuadri ligjor.**

- Ligji Nr.8485, date 12.5.1999 "Kodi I Procedurave Administrative" (ne fuqi ne kohen e vendimarrjes)

- Ligji nr 9947 date 07/07/2008 "Per pronesine industrial" i ndryshuar.

- VKM me nr 1706 date 29.12.2008 "Per Miratimin e Rregullore per Regjistrimin e Markave Tregtare te Sherbimit".

### **D) Zgjidhja juridike e ceshtjes objekt gjykimi.**

Procesi gjyqesor sjelle nje perballje juridike mes paleve ndergjyqese. Kjo perpallje konstaton ne ballafaqim pretendimesh, prapsimesh, provash dhe kriteresh apo interpretimesh ligjore te kuadrit ligjor te zbatueshem ne rastin konkret. Procesi gjyqesor qofte ai i posacem administrativ ka dy linja kryesore perballjeje mes paleve ndergjyqese. Perballja lidhur me ligjshmerine e veprimtarise administrative si dhe perballja ne procesin e te provuarit te rrethanave faktike.

Gjykata cmon te terheqe ne vemendjen e paleve permbajtjen e nenit 35 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykateve Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative". Ne kete nen parashikohet shprehimisht se: "**Organi publik ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimit tjeter administrativ, te nxjerre jo me kerkese te paditesit, si dhe faktet qe ai ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundershuar ne gjykate. Organi i administrates publike ka detyrimin te provoje ligjshmerine e veprimeve ne marredhenien e punes, nga e cila ka lindur mosmarrveshja, objekt gjykimi.**

**Ne rastet e tjera, pala ka detyrimin te provoje faktet, ne te cilat bazon pretendimin e saj.** Por edhe ne keto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim te ndermjetem, mund te vendose kalimin e barres se proves tek organi publik, kur ka dyshime te arsyeshme, te bazuara ne prova me shkrese, qe vertetojne se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova te rendesishme per zgjidhjen e mosmarrveshjes. Ky vendim ankimohet se bashku me vendimin perfundimtar.

Ky eshte nje moment i rendesishem per tu mbajtur parasysh ne gjykimin e posacem administrativ. Pasi ligjshmeria e veprimtarise administrative (ne cdo forme qofte ajo) eshte detyrim per tu provuar nga pala e paditur organ publik. Ne nje kohe qe perballja e paleve per faktet objekt verifikimi shkon unision me interesin e sejciles prej tyre per te provuar faktet qe kuadri ligjor lidh me to lindjen, ndryshimin apo shuarjen e e te drejtave dhe detyrimeve. Ne baze te cdo procesi gjyqesor qendron parimi klasik i barres se proves i cili kerkon qe faktin formues ta provoje pala qe pretendon lindjen e te drejtes perkundrejte provimit te ketij fakti. Pra fakt formues eshte ai fakt qe prodhon lindjen e detyrimit dhe kete fakt e provon pala paditese. Nderkohe qe faktin shues e ka detyrim per ta provuar pala e paditur. Fakti shues eshte ai fakt qe shuan pretendimin apo lindjen e detyrimit per palen paditese. Ky fakt duhet te provohet nga pala e paditur.

Ne kete proces gjyqesor eshte shume e rendesishme te theksohet fakti se ne themel te gjykimit eshte padia e pales paditese. Padia eshte e drejta e personit qe ben pretendimin, per t'u degjuar, mbi themelin e ketij pretendimi, ne menyre qe gjykata ta shpalle ate te bazuar ose jo. Pala kundershutare ka te drejte te diskutoje dhe te ngreje prapesime mbi themelin dhe bazueshmerine ne ligj te ketij pretendimi. (neni 31 I K.Pr.Civile).

Ne kete linje argumentimi pala paditese nuk duhet te mjaftoje vetem me ngritjen e pretendimeve per nje paligjshmeri vendimarrje te pales se paditur. Por pala paditese e ka detyrim ligjor per te pasur ne padine e saj nje interes te ligjshem. Pra ne cdo rast gjykata krahes verifikimit te bazueshmerise ne ligj apo jo te vendimarrjes se pales se paditur organ publik ajo ka detyrimin absolute te verifikojte edhe ligjshmerine e te drejtes se pretenduar nga pala paditese ne themel te kesaj padie.

Ne rastin objekt gjykimi jemi para nje vendimarrje te pales se paditur bazuar ne nenin 150/a/3 te ligjit marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave (Drejtori i Pergjithshem). Ne kete nen parashikohet se:

1. DPPM-ja, brenda tre muajve nga data e depozitimit te aplikimit per regjistrimin e nje marke, ekzaminon nese marka, perveg permbushjes se kerkesave formale, eshte ne perputhje edhe me kerkesat e neneve 140, pikat 2 e 3, dhe 142 te ketij ligji.
2. Nese marka nuk eshte ne perputhje me kerkesat e neneve 140, pikat 2 e 3, dhe 142, te ketij ligji, DPPM-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundesine te parashtroje, brenda dy muajve nga data e njoftimit, verejtjet dhe shpjegimet e tij ose te paraqese dokumente shtese.
3. Aplikimi refuzohet kur:
  - a) aplikuesi nuk parashton verejtjet e tij;
  - b) nuk ploteson dokumentacionin brenda afatit kohor;
  - c) nese DPPM-ja veren se aplikimi nuk eshte ne perputhje me percaktimet e neneve 140, pikat 2 e 3, dhe 142, te ketij ligji, edhe pas pergjigjes se aplikuesit. Ky vendim i njoftohet aplikuesit.

Vendimi per refuzimin e markes bazuar mbi shkaqet absolute per refuzim merret nga DPPM-ja vetem pasi eshte marre vendimi mbi kerkesat formale.

Pikerisht ne rastin konkret eshte vendosur refuzimi i markes me argumentin se marka qe kerkohet te regjistrohet nga pala paditese eshte nje marka qe bie ndesh me ate cka neni 140, pikat 2 e 3, dhe 142, te ketij ligji parashikon. Kjo eshte nje vendimarrje e Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave e drejtorit ekzekutiv te pales paditur. Pasi Drejtori i Pergjithshem eshte perfaqesuesi i kesaj drejtorie ne marredhenie me te tretet.

Ne shkresen me nr 599/4 prot date 17.05.2016 te quajtur Njoftim per refuzimin e regjistrimit te markes rezulton se pala e paditur duke patur parasysh se:

- Marka "Uje Natyral i Alpeve" pershkruan llojin e origjines se mallit per te cilin kerkohet te mbrohet marka.
- Elementet figurative te markes kane gjithashtu karakter pershkruar, ndeshen rëndom ne pamjet e etiketave te ujit dhe kane per qellim te tregojne ese kemi te bejme me uje burimi malor.
- Elementet uje natyral jane te perjashtuar nga mbrojtja;

Ashtu edhe si me siper eshte cituar rezulton se shkaku i refuzimit te regjistrimit te kesaj marke eshte fakti se marka qe kerkohet te regjistrohet eshte nje marka qe bie ndesh me kerkesat e ligjit me nenet 140, pikat 2 e 3, dhe 142, te ketij ligji.

Respektivisht ne keto nene parashikohet se:

- Neni 140: 1. Qdo shenje ose kombinim shenjash, qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar mallrat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik, eshte marka qe perfaqeson ato mallra ose sherbime, me kusht qe te permbushen kerkesat e neneve 141 deri ne 143 te ketij ligji (ne vijim do te quhet "marke").

2. Mund te perbejne marke shenjat e meposhtme:

- a) fjalet, perfshire emrat personale, shkronjat, numrat, shkurtimet;
- b) shenjat figurative, perfshire vizatimet;
- c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;
- g) kombinimet e ngjyrave e te drite-hijeve, si dhe ngjyrat ne vetvete;
- d) gdo kombinim i shenjave, te permendura nga shkronjat "a" deri ne "g" te kesaj pike.

3. Markat regjistrohen vetem nese ato mund te paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veganerisht me lloje te veganta markash, si zeri dhe sinjalet e drites, por jo vetem me keto.

Nga permbajtja e nenit 140/1 rezulton se marke eshte cdo shenje ose kombinim shenjash, qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar mallrat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik. Pra eshte e rendesishme qe nga ajo qe precepton konsumatori te arrihet te identifikohet personi fizik ose juridik qe i zotron kete mall dhe kete sherbim. Ne rastin konkret nga ajo cka pala paditese parashton dhe provon ne lidhje me gjendjen e faktit nuk provohet cila eshte paraqitja grafike e mallit per te cilin ajo kerkon regjistrimin e markes.

Gjithashtu ne kete gjykim nuk u arrit te provohet lidhja ndermjet markes qe kerkohet te regjistrohet dhe mundesise se identifikimit te subjektit qe e zotron kete malle nga nje subjekt tjeter qe prodhon apo tregon ate lloj malli. Respektivisht fjalet "Uje Natyral i Alpeve" pershkruan llojin e origjines se mallit per te cilin kerkohet te mbrohet marka dhe nuk mund te identifikojne dhe te vecojne ne treg subjektin qe e tregon kete mall.

Fjala Uje dhe fjala natyral kane karakter te pergjithshem dhe nuk mund te jene identifikuese dhe percaktuase per kete marke dhe per rrjedhoje nuk mund te mbrohen me fuqin e ligjit nepermjet regjistrimit te kesaj marke.

-Neni 142/ 1/ a dhe b i ketij ligji parashikon:

1. Nje shenje nuk regjistrohet si marke nese:

- a) nuk ka karakter dallues;
- b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve;

Ne rastin konkret eshte qartesisht e kuptueshme qe fjalet Uje Natyral i Alpeve nuk ka karakter dallues qe te sherbeje per te dalluar mallrat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, te aplikuesit per marke, Shoqeria {...} nga uje natyral te Alpeve qe mund te tregtohet dhe te hidhet ne perdorim per konsumatorin nga nje subjekt tjeter.

Ligji kerkon qe jo vetem te identifikohet dhe te dallohet si produkte por duhet qe elementet identifikues te markes te mos perbehen ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve.

Fjala Uje dhe fjala Natyral dukshem jane fjale me karakter te pergjithshem qe nuk mund te gezojne mbrojtje pasi nuk arrijne te identifikojne subjektin qe kerkon te regjistroje marken. Te thuhet ne nje marke Uje nuk mund te identifikosh kush eshte duke e prodhuar apo tregtuar Ujin respektiv si product. Gjithashtu te thuash ne nje marke Natyral nuk arrin te identifikojne palen paditese ajo eshte nje fjale me karakter te pergjithshem dhe nuk mund te identifikojne Shoqerine {...} shpk nga produkti i nje subjekt tjetere.

Per me teper fjala Alpe e perdorur ne kontekstin e Republikes se Shqiperise pa diskutim identifikon zonen gjeografike te Alpeve te Shqiperise. Nuk mundet paditese qe kerkon te regjistroje kete marke ne Republikën e Shqiperise te mbrohet me idene se Alepe perdoren ne nje kuptim te nje vargmali madheshtor. Pretendimi i pales paditese se Alpet nuk perbejne ndonje rajon apo lokalitet te vecant te territorit te Shqiperise nuk qendron pasi jo vetem ne gjuhen e perdritshme por edhe ne nje kuptim me specifik fjala alepe ne Shqiper identifikon dhe ngatrron absolutisht konsumatorin me Alepet e Shqiperise. Konsumatori ndryshe nga sa argumenton pala paditese duke u nisur nga emertesa e markes identifikon zone specifike gjeografike pikerisht zonen gjeografike te Alpeve te Shqiperise.

Pra per te gjitha sa me larte duke vleresuar kerkese padine ne thelbin e saj gjykata konkludon se Uje Natyral i Alpeve nuk eshte nje shenje ose kombinim shenjash, qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar mallrat apo sherbimet pales paditese Shoqeria {...}, nga ato te nje personi tjetere fizik ose juridik. Gjithashtu kjo kerkese nuk arrin te kaloje as kushtet e parashikuara nga neni 142 / 1 a dhe b te ketij ligji.

Sa me larte gjykata cmon se kerkesepadia e pales paditese nuk gjen mbeshtetje ne ligj dhe se pala paditese nuk arriti te identifikojne nje inteeres te ligjshem ne ngritjen e kesaj kerkese padie. Per rrjedhoje vendimarrja e marre nga drejtoria e Pergjitheshme e Markave dhe Patentave eshte e ligjshme.

Pala paditese ne rastin objekt gjykim ngre pretendime procedurale qe lidhen me vendimarrjen e Bordit te Apelimit. Respektivisht pala paditese pretendon se kjo vendimarrje eshte marre ne shkelje te rregullave per skualifikim te njerit prej antareve te tij, pikerisht behet fjale per drejtorin ekzekutiv te pales se paditur i cili ka refuzuar regjistrimin e markes ku njekohesisht eshte edhe pjesemarrjes ne vendimarrjen e Bordit te Apelimit.

Gjykata pasi verifikoi kete moment konkludoi se ky moment eshte i vertete. Por ne raport me zgjidhjen e e ceshtjes gjykata argumenton dhe konkludon si me poshte:

- Drejtori i Pergjithshem eshte perfaqesuesi i Drejtorise se Pergjitheshme te Markave dhe Patentave ne marrredhenie me te tretet. Pra ne cdo rast cdo vendimarrje administrative ne shkalle te pare te hetimit administrativ kalon me nenshkrimin e drejtorit te pergjithshem te organit publik pale te paditur;

- Ligji nr 9947 date 07/07/2008 "Per pronesine industrial" i ndryshuar, parashikon se ndaj ankimeve te Drejtorise se Pergjitheshme te Markave dhe Patentave (sipas emertimit te kohes) behet ankim prane Bordit te Apelimit.

- Sipas po ketij ligji Bordi i apelimit perbehet nga tre anetare, te caktuar nga Drejtori i Pergjithshem i DPPM-se, te cilet jane punonjes te kesaj drejtorie.

-Nuk ka asnje parashikim ligjor qe te perjashtojte automatikisht per shkak te funksionit drejtorine e pergjitheshme nga qenja pjese e Bordit te Apelimit.

-Marrja pjese e Drejtorit te Pergjithshem ne perberje te Bordit te aplimit ne rastin konkret per shkak te menyres se organizimit te veprimtarise eshte nje idikacion ngutshmerie ne vendimarrje;

-Nje nga anataret e Bordit te Apelimit eshte perjashtuar duke bere qe ky bordi i ngritur te ngelet me dy antare ne nje kohe qe i duhet te marre nje vendim;

-Efektivisht Bordi i Apelimit ka ne perberjen e tij vetem dy antare. Si rrjedhoje nese do te ikte si i dorehequr pasi nuk rezulton se pala paditese te kete paraqitur kerkese per perjashtim e ketij antari te bordit bordi i apelimit do te ngelte me nje antare ne pamundesi objektive dhe faktike te merrte nje vendim te ligjshem me shumice ne kete rast.

-Pala paditese nuk provoi se ne fazen e hetimit administrativ te kete kerkuar me kerkese perjashtimin e ketij antari te bordit. Edhe pse pala pka patur te gjitha mundesit per te ushtruar kete te drejte ajo nuk e ka bere nje gje te till.

-Ne nenin 33 te ligjit 44/2015 ne fuqi ne kohen e marrjes se kete vendimi nga Bordi i Apelimit parashikon se kur, per shkak te ligjit apo per shkak te situates konkrete, vertetohet se eshte i pamundur zevendesimi i nje zyrtari me nje zyrtar tjetere, lejohet vendimarrja nga nepunesi publik.

- Per me teper ne nenin 40/4 te ligjit 49/2012 parashikohet se: "Gjykata vendos rrezimin e padise dhe kur vlereson se, pavaresisht shkeljeve procedurale te konstatuara te veprimtarise administrative, pasojat do te ishin te njejta".

-Pretendimi ne themel te kesaj kerkese padie per regjistrimin si marke te Uje Natyral i Alpeve nuk ka bazueshmeri ne ligj dhe nuk ndjek nje inteeres te ligjshem.

Per te gjitha sa me larte gjykata konkludon se kerkese padia e pales paditese nuk gjen mbeshtetje ne ligj dhe ne prova dhe si e till ajo nuk prodhon asnje pasoje ligjore per palen paditese. Sa me larte kjo kerkese padi rrezohet nga gjykata si e pambeshtetur ne prova dhe ne ligj.

## Per keto arsye

### Baza Ligjore:

Gjykata mbeshtetur ne nenet 1, 39 - 43 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"; K. Pr. Civile; Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr 9947 date 07/07/2008 " Per pronesine industrial".

## VENDOSI:

**Vendosi:**

- €€€€€€€€ Rrezimin e kerkese padise.
- €€€€€€€€ Shpenzimet gjyqesore mbeten sic jane bere.
- €€€€€€€€ Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Administrativ Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme shpalljes. Per palen e paditur ne mungese ky afat fillon nga e nesermeja e marrjes dijeni per kete vendim.
- €€€€€€€€ U shpall ne Tirane, sot me date **19/06/2017**.

**SHPENZIMET GJYQESORE**

|                        |   |
|------------------------|---|
| <b>Kerkesepadia</b>    | 0 |
| <b>Taksa Gjyqesore</b> | 0 |
| <b>Noterizime</b>      | 0 |
| <b>Njoftime</b>        | 0 |
| <b>Akt ekspertimi</b>  | 0 |
| <b>Avokat</b>          | 0 |
| <b>Gjithsej</b>        | 0 |

**GJYQTAR:**

{...}